



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2024-002

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga A.Sh., nga Gjilani, kundër Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, më datë 05.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si e palejuar, ankesa e A.Sh., nga Gjilani, e paraqitur kundër kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan V.S..

A r s y e t i m

Kryetari i Gjykatës Supreme, konform nenit 9 par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka pranuar ankesën e palës A.Sh., ndaj kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan – V.S., si Autoritet Kompetent, sa i përket pretendimeve të shkeljeve disiplinore të Kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit (neni 9 par.1 nënpar.1.2 i ligjit të lartcekur).

Pala ankuese A.Sh., në ankesën e tij kundër kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, V.S., me pretendimet se janë duke u traumatizuar dhe dëmtuar financiarisht si pasojë e veprimeve arbitrare, dhe veprimeve tendencioze për të kurdisur lëndën civile C.nr.274/15.

Kryetari i Gjykatës Supreme pas shqyrtimit të pretendimeve në ankesës vlerësoi se:

- Ankesa është e palejuar.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës si dhe shkresave të lëndës, si autoritet kompetent vlerësojë se në rastin konkret nuk ka bazë ligjore për të hapur rast disiplinor ndaj kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, V.S.. Lidhur me pretendimet e palës, si autoritet kompetent kam vendosur edhe më herët me aktvendimin GJS-2023-022 të datës 26.09.2023, gjë që e bën këtë çështje të gjykuar.

Gjithashtu, nga shkresat e lëndës rezulton, lidhur me këtë çështje gjithashtu ka vendosur më parë dhe kryetari i Gjykatës Themelore në Gjiilan, atëkohë R.A..

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mënyrë shprehimore në nenin 5, ka paraparë rastet në të cilat konsiderohet se është kryer shkelje disiplinore, në rastin konkret rezulton se me veprimet e kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjiilan, V.S., nuk është konsumuar ndonjë nga shkeljet e parapara me këtë Ligj.

Duke u bazuar në këto, kryetari i Gjykatës Supreme vlerëson se një ankesë e tillë në bazë të këtyre pretendimeve është e pabazuar, për faktin se çështja e cila është objekt i ankesës, është çështje e gjykuar dhe se nuk kemi asnjë element të shkeljeve disiplinore.

Andaj, për shkak se në parashtresën e palës, nuk potencohet ndonjë shkelje konkrete e supozuar disiplinore, të cilat janë të parapara në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetarit të Gjykatës Themelore të Gjiilan,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.